

VENDIM
Nr.90, datë 28.1.2008

PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSINË
USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË SHTABET E
NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE
NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakët shqiptarë, për kohën që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, trajtohen me pagë për gradë dhe shtesë për përfaqësim, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Paga e atasheut ushtarak nuk mund të jetë më e lartë se ajo e ministrit këshilltar në përfaqësitë diplomatike. Në rastet kur Ministri i Mbrojtjes, në marrëveshje me Ministrin e Punëve të Jashtme, për shkak të ngarkesës së punës, emëron edhe një ndihmës të atasheut ushtarak, ky trajtohet jo më shumë se grada diplomatike e këshilltarit të përfaqësisë diplomatike.

2. Ushtaraku përfiton edhe kompensimin për koston e jetesës, si më poshtë vijon:

- 300 euro/USD, për vendet e grupit të parë;
- 260 euro/USD, për vendet e grupit të dytë;
- 230 euro/USD, për vendet e grupit të tretë;
- 200 euro/USD, për vendet e grupit të katërt;
- 150 euro/USD, për vendet e grupit të pestë.

Kategorizimi i përfaqësive, për efekt të koston së jetesës, është sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Paga shtrin efektet nga data e mbërritjes së ushtarakut në vendin e punës. Deri në këtë moment vazhdon të paguhet me pagën ekzistuese.

4. Ushtaraku, kur shkon për herë të parë në vendin e punës, merr, si paradhënie në valutë, pagesën e 15 ditëve, të cilën e shlyen brenda 6 muajve nga data e fillimit të detyrës. Nëse transferohet në atdhe para mbarimit të këtij afati, kundërvlerën e paradhënies së mbetur e shlyen në lekë, sipas kursit të këmbimit valutor, brenda 6 muajve pas kthimit në atdhe.

5. Paga mujore i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi. Në bazë të saj do të paguhet edhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

6. Paga mujore i nënshtrohet rishikimit në të njëjtën formë, si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

7. Pagesat për ushtarakët, që shërbejnë në vendet e Europës, bëhen në euro, ndërsa për vendet e tjera në USD.

8. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, brenda fondeve buxhetore vjetore, shpenzimet për pagat e atasheve ushtarakë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare.

9. Pika 2 e kreut I dhe pikat 2, 3, 4, 9, 11 e 12 të kreut II të vendimit nr.115, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të atasheve ushtarakë dhe oficerëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s”, të ndryshuar, shfuqizohen.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

11. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008, ndërsa për periudhën nga 1 korriku 2007 deri më 31 dhjetor 2007 zbatohen pagat aktuale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emërtimi	Paga në euro	Paga në USD	Shtesë përfaqësimi
	Përfaqësia e NATO-s			
1.	Gj. Lejtnant	1100	1330	75%
2.	Gj. Major	1080	1280	60-75%
3.	Gj. Brigade	1000	1200	60-75%
	Përfaqësitë e tjera			
1.	Kolonel	900	1100	40-60%
2.	Nënkolonel	850	1040	40-60%
3.	Major	800	980	40%
4.	Kapiten	750	950	40%
5.	Toger	700	850	40%
6.	Nëntoger	650	800	40%
7.	K/Kapter	700	850	40%
8.	Kapter	620	750	40%
9.	Rreshter	500	590	40%
10.	Tetar	400	500	40%
11.	Nëntetar	350	450	40%

Shënim: Gradat gjeneral major dhe gjeneral brigade përfitojnë shtesën për përfaqësim në nivel maksimal kur emërohen në pozicionin e shefit të misionit

Lidhja nr.2

KATEGORIZIMI NË BAZË TË KOSTOS SË JETESËS

300 euro/ \$	260 euro/ \$	230 euro/ \$	200 euro/ \$	150 euro/ \$
Londër Gjenevë Moskë	Vjenë Washington Paris Romë Berlin Madrid Napoli Oberamergau Brunssum Florida SHBA	Bruksel NATO Mons Athinë Ankara Hagë Stokholm Varshavë Budapest	Zagreb Izmir	Shkup Bukuresht